

TULAREMIA NË KAFSHË

Nga Prof. Kristaq BËRXHOLI

HYRJE

Tularemia, **SËMUNDJE ZOONOTIKE**, është një infeksion ciklik që prek kafshët dhe njerzit. Njerzit e marrin infeksionin nga kafshët, me bakteriem dhe toksiem që shpesh zhvillohet në formë shumë të rëndë. Infeksioni shkaktohet nga **Francisella tularensis**. Para së gjithash tularemia është infeksion i brejtësve të egër, infeksion i cili ruhet në këto vatra të egra duke qarkulluar nga kafshët tek riqnat. Ajo herë pas here mund të prekë kafshët shtëpiake dhe në disa raste të vecanta dhe njerëzit të cilët ose futen në vatrën natyrore ose konsumojnë produkte e ujë të kontaminuar. Tek njerëzit ajo është ngjitëse, ku mbyllet dhe zinxhiri infektues. Tularemia pjesërisht është metazoonozë pasi transmetohet nëpërmjet arthropodeve, njëkohësisht është dhe kontaktzoonozë si dhe sëmundje profesionale.


Shkaktari.

Francisella tularensis (F.t), nga McCoy dhe Chapin në vitin 1912 (syn. *Pasteurela*, *Brucella*) është me madhësi nga 0.2- 0.5 x 0.3- 0.7 mm, shumë polimorf, gram negativë dhe shkop i palevizshëm, që nga pikëpamja filogjenetike qëndron pranë brucelave. Dallohen dy biovarë : biovari A , F.t var.*tularensis* glyceriono pozitiv, patogjen i fuqishëm më shumë tek lepujt dhe riqnat e tyre, dhe biovari B, F.t var. *palae-(holo)-artica*, e cila prek me shumë brejtësit e egër dhe gjëndet në uje, është patogjen i dobët dhe është verëjtur në Euroazi dhe Amerikën e Veriut. Në Amerikë, megjithëse rrallë është parë specia *F.novicida* e izoluar nga mostrat e ujit. Ajo ndryshon nga F.t nga pikëpamja serologjike, porse genoma e të dy llojeve është e ngjashme në hibridizimin e ADN. *Francisella* ka një metabolizëm oksidativ (aerob obligativ). Për rritjen kërkon cistein ose cistinë dhe sheqerna të cilat shpërbëhen me vështirësi dhe ngadalë. Vërehet një reaksion i kryqëzuar me brucelat dhe ekstrakti i saj jep reaksion precipitimi me antiserumin antipest. Format – S janë virulente dhe kanë antigjen të kapsulës, ndërsa format avirulente R posedojnë vetëm antigenin O. Shtamet e dobëta, por me cilësi të mira antigjenike, mund të përdoren për të prodhuar vaksinën e gjallë kundër saj (tularemisë). Antigeni kapsular, që çlirohet në culture, humbet pas pasazheve, gjë e cila nuk ndodh kur ato shumëzohen në embrionet e vezëve.

Epidemiologjia

Tularemia, që nga koha e identifikimit të saj, është raportuar thuajse në të gjithë botën. Në vitin 1999, në Kosovë u vërejtën rreth 250 – 300 raste të tularemisë në njerëz. Infeksioni u diagnostikua në Institutin e Kërkimeve Veterinare “ Bilal Golemi “ në Tiranë me anën e provës serologjike në lamë dhe në tub. Ky ishte rasti i parë i diagnostikimit të infeksionit në vendin tone në njerëz. Gjatë kësaj periudhe, në vendin tonë, u bënë dhe disa kërkime në njerëz për të cilët dyshohej për prezencën e saj. Nga këto kontrole infeksioni u diagnostikua vetëm në një grua në zonën e Hasit. Qysh prej vitit 1999, në vendin tonë nuk janë vërejtur raste të dyshimta infeksioni si në njerëz ashtu dhe në kafshët e brejtës të egër. Tularemia është gjetur tek së paku 110 lloje të ndryshme kafshësh, 25 lloje zogjsh dhe disa lloje peshqish. Është gjetur tek riqnat e gjinis *Ixodes*, *Dermacentor*, *Haemophysalis spec.*, etj, po kështu është parë tek tabanitet, tek morrat dhe tek mizat. Tek morrat, dhe pleshtat ato strehohen dhe transportohen. Brejtësit, si minjtë e mëdhenj të kanaleve (*Arvicola terrestris*), lepuj etj, si dhe disa insekte mishngrënëse, janë mjaft të ndjeshme kundrejt infeksionit dhe sëmuren gjithashtu rëndë. Biovari A takohet tek lagomorfet, kurse Biovari B holoarktik më shumë takohet tek brejtësit e vegjël. Gjithashtu të ndjeshëm por që preken pak janë minjtë e fushës (*Microtus arvalis*, *Apodemus*- Arten), hamsterat, lepujt, shqiponjat etj dhe nga kafshët shtëpiake dhentë dhe lepujt që rriten në shtëpi. Njëhundraçet si dhe mishngrënësit janë pak të ndjeshëm, porse sëmuren me shumë se vizonët dhe dhelprat.

Kafshët me ndjeshmëri shumë të lartë, janë **Rezervuarët e gradës së 1** dhe para së gjithash epizootik, ngjitës për njeriun dhe krijojnë vatra infektive. Kafshët e tjera, pak të ndjeshme dhe që tek to prekja ka karakter kronik dhe sëmundja nuk është e rëndë krijojnë rezervuarë permanentë të gradës së 2, në të cilën infeksioni përjeton me vite të tëra midis epizootive. Tek ripërtpësit e egër si p.sh drerët etj si dhe gjedhët ,derrat, rosat e egra, fazanët, zogjtë vjedhës, patat, kafshët me gjak të ftohtë, sëmundja është e parëndësishme nga pikëpamja epidemiologjike. Shumëzimi i F.t, në sipërfaqe të ujërave dhe llucës ende është e diskutueshme. Ato jetojnë në tokë, deri në dy muaj, kur ajo ka pH alkaline. Në drithërat e kontaminuara deri në 3 muaj, në sipërfaqe të ujit nga 1-3 muaj, tek kadavrat deri në 4 muaj, substratet e ngrira 3 muaj dhe në shtresën e thatë të stallave të dhëneve deri në 6 muaj. Sipërfaqet e ujërave infektohen nga kadavrat dhe brejtësit. Vatrata infektive të egra, nëpërmjet riqnave, mbeten si rezervuarë natyrale. Tek riqnat Ixodes ricinus, Dermacentor marginus, Haemophysalis, Ripicephalus, Ornithodoros spec. etj , mikrobet transmetohen në rrugën transstadiale dhe ndoshta dhe nëpërmjet rrugës transovariale. Riqnat e rritura si dhe mizat e transmetojnë infeksionin tek njerëzit dhe kafshët shtëpiake. Shumëzimi i shumtë i brejtësve, në kohë me mot të mirë dhe me kondita tokësore të përshtatshme shkakton edhe rritjen e infeksionit, përkundrazi në kohë të keqe, me pakësim të ushqimit , në prezencën e parazitëve etj infeksioni bie. Periudha e luftërave si dhe ato pas luftërave, shtimi i popullacionit të riqnave etj, janë faktorë që shkaktojnë shtimin e infeksionit.



CIKLI I TULAREMISË

Patogjeneza

Në organizmin e kafshës, shkaktari shumëzohet në vendin e hyrjes, gjë e cila shkakton dhe një inflamacion të nyjeve limfatike regjionale, kështu që shfaqet një kompleks primar i jashtëm ose i brendshëm njësoj si tuberkulozi. Tek kafshët me ndjeshmëri të lartë kundrejt tij, infeksioni përhapet me rrugë lymfatogjene dhe atë hematogjene, ku si pasojë e të cilës shfaqet septisemia e cila shkakton vdekjen e kafshës. Si pasojë e kësaj në organe të ndryshme shfaqen vatra të vogla (miliare) nekrotike të cilat janë më të shprehur sidomos në mëlci, shpretkë dhe në nyjet limfatike.

Anatomopatologjia

Ndryshimet anatomo-patologjike variojnë shumë në varësi të virulencës së shkaktarit, nga mënyra dhe vëndi i futjes në organizëm, nga lloji dhe mosha e kafshëve, nga ndjeshmëria dhe nga zhvillimi i sëmundjes. Ndryshimet anatomo-patologjike konsistojnë në vatrave nekrotike si dhe proliferacion i qelizave të sistemit retikuloendotelial. Vatrave nekrotike janë me madhësi nga ato miliare deri në madhësinë e një komce, pjesërisht të kazeuara, me pamje të bardhë deri në gri të verdhë. Vatrave vërehen në nyjet limfatike, mëlci. Shpretkë si dhe në mushkëri por edhe në palcën kockave. Në rastin e formës superakute, mëlcia është e zmadhuar shumë dhe në të si dhe tek mushkëritë apo palcën e kockave vërehen vatra inflamative me ngjyrë gri në të verdhë. Nyjet limfatike gjithashtu janë të zmadhuara. Në rastin e tularemisë tek dhentë e vdekura, vërehet hemoragji dhe nekroza në indin e nën lëkurës, enjtje dhe hemoragji gjithashtu në nyjet limfatike, enjtje e mëlcisë si shpesh vatra pneumonie. Brenda vatrave nekrotike të formuara në mushkëri vërehen shkaktarët e tularemisë të cilët pak a shumë evidentohen qartë.

Klinika

Sëmundja vërehet në verë dhe në periudhën e aktivitetit të lartë të shumëzimit të riqnavë. Brejtësit me ndjeshmëri të lartë të shfaqin sëmundjen pas një periudhe inkubacioni prej 2-3 ditë dhe shprehet kryesisht me ethe dhe septisemi, lodhje, shtim të frymëmarrjes dhe brenda 1-2 javësh ata vdesin. Në rastin e formës septisemike ata sëmuren shumë rëndë dhe gjenden të vdekur. Forma kronike me dobësi të theksuar si dhe rritjen në volum e nyjeve limfatike është e rrallë dhe shkakton vdekjen e brejtësve brenda 2-8 javëve. Forma kronike deri në atë latente, vërehet tek kafshët me ndjeshmëri të pakët si p.sh sisorët dhe zogjtë, shfaqen me dobësi dhe abscese në organet e brendëshme, porse klinikisht ato janë të shëndetshme. Qengjat në kullotë paraqesin shënja të një hutimi, dispnoe, paralyzë dhe rritje në volum të nyjeve limfatike, ndërsa deshët preken kryesisht nga forma subklinike, kurse dhente barsa dështojnë. Morbiliteti mund të arrijë 10- 50 %, ndërkohë që zgjatja e sëmundjes mund të jetë nga 4- 8 javë. Tek kuajt (pelat) mund të vërehen dështime, po kështu dhe tek lopët. Infeksioni tek derrat kalon kryesisht në formë subklinike dhe me temperaturë, ndërkohë që dëmtime vërehen vetëm tek gicat.

Diagnoza

Po të bazohemi vetëm në të dhënat e klinikës dhe ato të ndryshimeve anatomo – patologjike, nuk mund të vendosim një diagnozë të sigurt. Një tregues për mundësinë e prezencës së infeksionit të tularemisë janë vdekjet e shumta tek brejtësit e egër. Është e domosdoshme që materialet patologjike të dërgohen në laborator.

Mjekimi

Trajtimi i kafshës bëhet para së gjithash në vatrave dhe dhenve të prekura nga tularemia. Kafshët e prekura pastrohen nga riqnat duke përdorur Akaricidet ose Pyretroidet, ndërsa qengjat klinikisht të sëmurë, mjekohen me oxytetraikline. Në rastin, kur tek brejtësit të egër, vërehen vdekje, atëherë menjëherë merren masa, që dhentë dhe qentë që janë në atë zonë të kontrollohen për riqna dhe nese kanë, ato luftohen, si dhe gjithashtu luftohen edhe brejtësit e gjallë që janë në vend qëndrimet e dhënve.

Luftimi.

Tek kafshet, tularemia, është sëmundje që para se gjithash prek lepujt. Është sëmundje e detyrueshme për deklaram. Mendohet se tularemia prek edhe brejtësit e tjerë. Tularemia në vëndet Evropiane merret nga toka . Për ta luftuar këtë sëmundje duhet të kihet parasysh që ajo transmetohet nga kafshët e egra, riqnat dhe mishi i tyre. Për këtë; është e detyrueshme; që kur kemi vdekje masive të kafshëve të egra, **SIDOMOS LEPUJ**, të njoftohet menjëherë shërbimi veterinar. Kjo duhet patur parasysh edhe gjatë gjuetisë së lepujve. Në këto raste, nëqoftëse gjënden lepuj të vdekur, këto çohen direkt në laboratorët special për ti kontrolluar. Nuk duhet asnjëherë që të hiqet vëmendja nga mishi që konsumohet nga lepujt e egër. Në disa vënde, bëhet luftë sistematike si kundër tularemisë sylvatike, ashtu dhe kundër asaj rurale. Po kështu bëhet luftë edhe kundër rriqnave e cila është e njëjtë, si në rastin e luftimit të encefalitit kërpushor (shif ZOONOZAT-2015).

**Shënim: Për më tepër informacion, lexoni librin ZOONOZAT nga:
Prof. Kristaq BËRXHOLI dhe Dr. Albana ÇUKO, botim i vitit 2015**

***Nuk lejohet ripublikimi i këtij materiali pa lejën e redaksisë ose autorit të shkrimit.
Ju lutemi në rast referimi nga ky shkrim të përmendet linku i veterineret.com si
dhe autori i shkrimit!***